



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA EL KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVO  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: Priljeno: 03.06.2024		
Njësia Jednica	Numri Braj	Shtojca Dodatak
05-453/01-27167		



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, 03/06/2024

Thirrje publike për ofrimin e mbështetjes financiare publike për financimin e projekteve/ programeve të OJQ-ve të regjistruara.

**1. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport** u bënë thirrje të gjitha organizatave jo-qeveritare të Regjistruara në Republikën e Kosovës që veprimtarinë e vet e zhvillojnë në Komunën e Lipjanit të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në **avancimin e rinisë dhe kulturës në Komunën e Lipjanit.**

2. OJQ-të në përputhje me këtë thirrje publike mund të aplikojnë me projekt në lëmin e rinisë dhe kulturës përmes objektivave e aktiviteteve rinore dhe kulturore, që janë të shumëllojshme dhe përfshijnë zhvillimin personal, social, dhe kulturor të të rinjve.

**Këto aktivitete synojnë:**

- 1. Qasjen në arsim cilësor dhe mosbraktisja e shkollimit nga të rinjtë**
- 2. Integrimi social, demokratik si dhe pjesëmarrja e të rinjëve në vendimmarrje dhe politikëbërje**
- 3. Shëndetin fizik, mendor i të rinjëve dhe shëndeti seksual, riprodhues**
- 4. Siguria kibernetike e të rinjëve**
- 5. Parandalimin e dhunës dhe vrasja në baza gjinore**
- 6. Kycja/aktivitetet e personave me aftësi të kufizuara**
- 7. Marrdhëniet dhe ndërveprimet ndëretnike**
- 8. Vullnetarizmi i rinisë**

Këto objektiva ndihmojnë në formimin e një rinie të shëndetshme, të informuar dhe të angazhuar, e cila është e gatshme të kontribuojë pozitivisht në shoqëri.

3. Përfituesi do të kujdeset për: Ofrimin e projekteve me të cilin do të përmbushen të gjitha objektivat e thirrjes publike (detajet tjera rreth kësaj thirrje do të i gjeni në udhëzuesin i cili do të publikohen në web faqe, së bashku me formularët e aplikimit)

4. Organizatat jo-qeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuojnë në avancimin dhe fuqizimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit.

Numri i OJQ-ve që do të mbështeten nga kjo thirrje është pesë deri tetë (**5 deri 8**) OJQ.

Vlera totale e mbështetjes sipas thirrjes është **50,000.00 euro** (pesëdhjetë mijë euro)

5. Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është 15 ditë pune dhe përfundon me datën **25.06.2024**.

6. OJQ-të duhet të prezentoj në dokumente edhe dosjen për punët e ngjashme të kryera më herët, referencë për projektet e ngjashme nga financuesit.

OJQ –ja dhe Partnerët e saj nuk duhet të kenë avance të pa mbyllura tek ofruesi i Thirrjes së paku 10 ditë para shpalljes së Thirrjes Publike.

Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave jo-Qeveritare në Republikën e Kosovës, dhe të cilat veprojnë në Komunën e Lipjanit para datës së publikimit të thirrjes publike. OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e kulturës, rinisë dhe rekreacion. OJQ duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Drejtoratit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike.

Para nënshkrimit të kontratës, OJQ duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ ka zgjidhur çdo çështje të hapur rreth pagesës së kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

7. Një aplikant (OJQ), nuk mund të aplikojnë në më shumë se një program, dhe drejtorët e OJQ-ve aplikuese nuk mund të jenë në lidhje të ngushtë familjare me drejtorët, përkatësisht aplikantët e OJQ-ve tjera aplikuese.

8. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilat së bashku me Udhëzimet për Aplikantët, janë në dispozicion në faqen e internetit të ofruesit të mbështetjes financiare (<http://kk.rks-gov.net/lipjan/>).

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen personalisht, në adresën e mëposhtme:

**KOMUNA E LIPJANIT**

**Rruga „Shqipëria”**

**Zyra për shërbim të qytetarëve, nr 3,**

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendarin tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në Udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.

9. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: **[pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net](mailto:pranvera.i.krasniqi@rks-gov.net)**

**Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport**

**Anila Reçica Llugiqi**

